



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

DREJTORIA ADMINISTRIMIT PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr _____ prot

Datë ____/____/2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 29, datë 25.06 2025

“ DHËNIE PËLQIMI NË PARIM PËR DHËNIE ME QIRA TË PASURISË PREJ 1 HA, NDODHUR NE EKONOMINE PYJORE MAMËZ-KALIMASH, NJËSIA ADMINISTRATIVE KOLSH, BASHKIA KUKËS, NGA STRAT Nr. 57/a DHE 57/c, “PER VENDOSJE KAMINASH PËR PRODHIM QYMYR DRURI DHE ESHKËS SË KOVAÇIT, FURRË GËLQEREJE, SHESHE PËR DEPOZITIMIN E PËRKOHSHËM TË MATERIALEVE TË NDRYSHME (PIKË TRANSITI) ETJ”.

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 të miratuar me datë 17.12.2015 “Për veteqeverisjen vendore” nenet 8/2, 9/1/1.1/b, 27, 54, (i ndryshuar), Ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative të RSH”, Ligjin Nr.57/2020, datë 30.04.2020, “Për Pyjet” neni 25, Ligjin Nr. 9693, date 19.03.2007 “Per fondin kullosor” (i ndryshuar), VKM Nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive” VKM nr. 684 date. 02.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 433, datë 08.06.2016 te Keshillit të Ministrave, pika 6 e VKM nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, V.K.M Nr. 888 datë: 27.12.2022, “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosore publik” si dhe urdherit nr 1054 datë 23/06/2025 të Kryetarit të Bashkisë, Vendimin Nr 44 date 25/06/2025 “Për miratimin e raportit tekniko-ekonomik si dhe vazhdimin e perocedurave ligjore për dhënie me qira të sipërfaqes së fondit pyjorë i propozoj Këshillit Bashkiak Kukës të:

MIRATOJË:

- 1- Dhënie pëlqimi ne parim për dhenien me qira te pasurisë prej 1 ha, ndodhur ne ekonomine pyjore Mamëz-Kalimash, njesia administrative Kolsh, Bashkia Kukes, n/ngastra 57/a dhe 57/c, “Për vendosje kaminash për prodhim qymyr druri dhe eshkës së kovaqit, furrë gëlqereje, sheshe për depozitimin e përkohshëm të materialeve të ndryshme (pikë transiti) etj”.

- 2- Dhënia me qira do të realizohet nëpërmjet procedurave të Prokurimit Publik dhe elementeve të tij, në përputhje me kriteret e përcaktura sipas legjislacionit në fuqi për administrimin e fondit pyjor.
- 3- Afati i dhënies me qera të jetë 10 vjetë me të drejtë rinovimi.
- 4- Vlera fillestare e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM nr 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”.

KRYETARI

Albert HALILAJ

